



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:043178

Datë: 18.01.2019

Numri i dokumentit: 00208021

P.nr.84/2018

NË EMR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë prej gjyqtarit Xheladin Osmani, si kryetar dhe gjyqtareve Ajser Skenderi dhe Teuta Krusha, si anëtar të trupit gjykues, në lenden penale kundër të akuzuarit A.D nga Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale vrasje në tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 par.1 të KP, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda PP/I.nr.98/18, e dt.12.10.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesore publik, më datë:17.01.2019, në prezencën e prokurorit të shtetit Metush Biraj, të akuzuarit dhe mbrojtësit Av.H.S, më dt.17.01.2019, muar dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.D, nga i ati F dhe ëmës H, me mbiemër të vajzërisë P, i lindur me datën ... në Prishtinë, ku edhe tani jeton, shqiptar, shtetasi Republikës së Kosovës, me numër personal, absolventë i Fakultetit Juridik në Prishtinë, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTORË

1.Se i akuzuari A.D me dashje ndërmerr veprime për kryerjen e vrasjes, por vepra nuk është kryer ose elementet e saj nuk janë realizuar, në atë mënyrë që më datë 03.08.2018, rreth orës 15:00, afër kafiterisë “D.”, në fshati ... - Komuna e Suharekës, për shkak të dyshimit se është në lidhje me nënën e tij, nga automjeti i tij i parkuar i tipit “Smart” me ngjyrë të bardhë, me armen gjysmë automatike ngjyrë hiri metalik, të tipit “Zoraki-906” e konvertuar nga pistoletë e gazit, në armë të zjarrit, të kalibrit 7.65x17 mm, në

distancë prej 3-4 metrave, shkrep katër herë në drejtim të të dëmtuarit S.D, të cilin me një plumb e ka godit në harkun brinjor majtas, e pastaj plumbi del në murin e përparmë të majtë të abdomenit, të cilit i shkakton dëmtime të rënda trupore me pasoja të përkohshme në shëndet.

Me këtë ka kryer veprën penale vrasje në tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 par.1 të KP,

2.Në vend dhe kohë të njëjtë të përshkruar më afërsisht sikurse në piken një të dispozitivit të aktakuzës, në shkëlje të ligjit të zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armën gjysmë automatike të tipit “Zoraki-906”, me ngjyrë hiri metalik, të konvertuar nga pistoleta e gazit në armë zjarri, të kalibrit 7.65x17 mm.

Me këtë ka kryer veprën penale mbajtja, në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP.

Gjykata në bazë të nenit 3,7,8,9,10,21,,41,42,43,45,46,47,73,74,75,76 të KP

V e r t e t o n

Të akuzuarit A.D, për veprën penale vrasje në tentativ nga neni 178 lidhur me nenin 28 par.1 të KP, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite.

Për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KP, dënimin me burg në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj.

Gjykata në kuptim të nenit 80 të KP.

G J Y K O N

Të akuzuarin A.D me dënim UNIK, me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite e 6 (gjashtë) muaj, ku do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe në arrestin shtëpiak prej datës dt.03.08.2018 gjer më datën 17.01.2019, në dënimin e shqiptuar.

Gjykata, në bazë të nenit 374 par.3 e lidhur me nenin 69 të KP, ndaj të akuzuarit, shqipton dënim plotësues;

MARRJEN E SENDIT

Ashtu që prej të akuzuarit A.D, merret arma –Pushka gjysmë automatike e tipit “Zoraki-906”, kalibrit 7.65x 17mm, ngjyrë hiri metalike e konvertuar nga pistoleta e gazit në armë të zjarrit.

I dëmtuari S.D, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari A.D që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 150 (njëqindpesëdhjetë) euro, në afatin prej 15 ditëve, nga dita e formës së prerë të aktgjykimit.

Në bazë të Qarkores së Gjykatës Supreme të Kosovës për zbatimin e Ligjit nr.05/L-36, për kompensimin e viktimave të krimit të dt.30.01.2018, obligohet i pandehuri A.D që konform nenit 39 të Ligjit të lartcekur të paguajnë se cili shumën me nga 50 euro në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.98/2018, të dt.12.10.2018, ndaj A.D, Komuna e Prishtinës, për shkak të veprës penale vrasje në tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 par.1 të KP, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP, aktakuzë të cilën në të gjitha fazat e shqyrtimeve e ka përfaqësuar Prokurori i Shtetit Metush Biraj, i cili në fjalën përfundimtare ka theksuar: pasi që i akuzuari në përputhje në kushtet të parapara me ligj, ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilën është akuzuar, gjykatës i propozoj që si rrethana lehtësuese të ketë parasysh qëndrimin e tij korrektë dhe të sinqertë gjatë gjithë fazave të procedurës, pendimin e tij të thellë dhe faktin se nuk kemi të dhënë që i njëjti ka pasur procedurë tjetër penale, kurse prej rrethanave rënduese gjykatës i propozoj të ketë parasysh peshën e veprave penale të kryera e sidomos shkallën e tij të përgjegjësisë.

Njëherit gjykatës i propozoj që të akuzuarit të shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i pushkës gjysmë automatike të sekuestruar, mjet me të cilën ka kryer veprat penale.

I dëmtuari S.D, në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se nga momenti i plagosjes me armë gjendja ekonomike tek unë është dobësuar dukshëm, jam i pa punë, ngase pronari ku kam punuar nuk më len të punojë, parashtrijë kërkesën pasuroro juridike në kontestin e rregullt civil.

Kompetencat

Ligji mbi Gjykatat, ligji nr.03/L-99 (LC) gjithashtu ka hyrë plotësisht në fuqi me 1 Janar 2013 (neni 430) më të cilin e rregullon kompetencën territoriale dhe lëndore të gjykatës.

Vepra penale bie në kompetencën territoriale dhe lëndore të Gjykatës Themelore në Prizren, vrasjet dhe vrasjet e rënda kanë dënimin prej se paku 5 vite respektivisht 10 vite burgim dhe bien në kompetencë lëndore të Gjykatës Themelore –Departamenti për Krime të Rënda (neni 20 par1) të KPP dhe nenit 11 të Ligjit për Gjykatat , Ligji nr.03/L-199, pasi që vepra penale është kryer në territorin e Komunës së Prizrenit, e kjo bie në kompetencën e Gjykatës Themelore në Prizren, (neni 29 0 të KPP).

Vepra penale vrasje nga neni 178 të KP.

*kushdo që e privon personin tjetër nga jeta dënohet jo më pak se pesë (5)vjet burgim.

Tentativa – neni 28 i KP.

Par.1 kushdo që me dashje ndërmerr veprimet për kryerjen e veprës penale por vepra nuk është kryer ose elementet e veprës penale nuk janë realizuar, konsiderohet se ka tentuar të kryejë veprën penale.

Vepra penale; Mbajtja në pronësi, kontroll ose në posedim të paautorizuar të armeve.

Kjo çështje rregullohet ne nenin 374 par.1 të KP. “kushdo që mban në pronësi, kontroll ose posedon armë në shkelje me ligjin e zbatshëm lidhur me armë të tilla , dënohet....”

Trupi gjykues konsideron se kontrolli përfshin ruajtjen apo mundësin e qasjes së armës dhe posedimi përfshin posedimin personal të armës njësoj sikur ta kesh armen.

Pistoleta e markes “Zoraki-906”, gjysmë automatike e konvertuar nga pistoleta e gazit, të kal.7.65x 17 mm, me ngjyrë hiri metalike, të cilën e ka përdorur i akuzuari, përkufizohet nga neni 120 par.38.1 si armë zjarri, gjithashtu ky nen e përkufizon municionin për armë zjarri si armë dhe sipas Ligjit për armët për të cilat nuk mundë të merret leja nga personi fizik.

I akuzuari A.D, gjatë këtij shqyrtimi kryesor të dt.17.01.2019, ka pranuar fajësinë për veprën penale vrasje në tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 par.1 të KP dhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KP,

Në bazë të pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit A.D vërtetua në tërësi pretendimi i prokurorisë për veprat penale të përshkruar si nen I/ dhe II/ të dispozitivit të aktakuzës dhe aktgjykimit, për veprën penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 par.1 të KP, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose në posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KP,

Trupi gjykues vërtetoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit dhe se pranimi është bërë vullnetarisht, pastaj pranimi është mbështetur në faktet e çështjes që përmban aktakuza, nga materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe provat tjera dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të çart ligjore ose gabime faktike, të akuzuarit A.D pranoj fajësinë për veprën penale vrasje në tentative nga neni 178 lidhur me nenin 28 par.1 të KP dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontrolle ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 374 par.1 të KP.

Gjykata, nga provat të bashkangjitur në shkresat e lëndës, mbi të cilat është bazuar dhe ngritur aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda, e poashtu edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprat penale që i vëhen në barrë, duke i analizuar secilën veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku më pa dyshim është ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, formohen dhe fitohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se i akuzuari në aspektin penal- juridik është përgjegjës për çka gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Avokati H.S deklaroj: konsideroj se me pranimin e fajësisë të të akuzuarit A.D gjendja faktike sipas pretendimeve nga aktakuza në tërësi u vërtetua.

Mbrojtësit i ka ngelur që t'i drejtohet trupit gjykues që me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese më të cilat do të ndikonin në zbutjen e dënimit të shqiptuar.

Përveç kësaj vet i akuzuari A.D, nga fillimi i çështjes së tij penale në policinë e Kosovës, tek prokurori i shtetit dhe shqyrtimin kryesor pa mëdyshje e ka pranuar kryerjen e kësaj vepre penale. Po ashtu për herë të parë A.D ka ardhur në konfortim me normat juridike, pastaj rrethanat personale të të akuzuarit si dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprës penale.

Prandaj në këtë drejtim propozoj që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim më i butë me të cilin do ta arrihej qëllimi i dënimit të shqiptuar.

Njëkohësisht i propozoj që me ditën e shqiptimit t'i ndërpritet edhe masa e arrestit shtëpiak.

I akuzuari A.D, në tërësi mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, e ndi veten fajtor, pendohem për veprën dhe jap fjalën gjykatës që në të ardhmen këso veprime nuk do të përsërisë.

Gjykata, nga provat të bashkangjitur në shkresat e lëndës, mbi të cilat është bazuar dhe ngritur aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda, e po ashtu edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale që i vëhet në barrë, duke i analizuar secilën veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku më pa dyshim është ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, formohen dhe fitohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se i akuzuari është përgjegjës në aspektin penal-juridik, për çka gjykata të njëjtin e shpalli fajtor.

Gjykata, gjatë shqiptimit dhe matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, e në kuptim të nenit 73, 74 dhe 75 par.1 p.1.3 të KP, pati parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në zgjedhjen e llojit të lartësisë së dënimit, duke e gjetur si rrethanë posaçërisht rënduese, rrezikun shoqëror, shkallën e rrezikut të vlerës së mbrojtur, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese është marrë sjellja korrekte e të akuzuarit gjatë tërë procedurës, pranimin e fajësisë, është penduar, i jep fjalën Gjykatë se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të tilla kundërligjore, për këtë gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, e bindur se edhe me këtë masë do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, u muar në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimi mbi konfiskimin e sendit është marrë në kuptim të nenit 374 par.3 nenit 62 p.2 pika 2.7 dhe 69 të KP-së.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në dispozitat e nenit 450 par.2.6 të KPP-së.

Vendimin mbi kompensimin e viktimave të krimit u muar në bazë të Qarkores së Gjykatës Supreme të Kosovës për zbatimin e Ligjit nr.05/L-36, për kompensimin e viktimave të krimit të dt.30.01.2018.

Andaj, nga të cekurat si më lartë është vendosur si në shqiptim të aktgjykimit.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA ,
2018:043178, 17.01.2019**

**Kryetari i trupit gjykues,
Xheladin Osmani**

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.